

| RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT | |
|--|--|
| EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS | Projekt-ligj ”Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji” |
| MINISTRIA UDHËHEQËSE | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise. |
| FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT | Finale |
| BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS | Ndërkombetar-transpozim i BE-së |
| DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së | Direktiva 2017/1369/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 Korrik 2017 që përcakton kornizen për etiketimin e energjisë dhe shfuqizon Direktivën 2010/30/BE. https://eurlex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32017R1369; HTTPS://WWW.ENERGY-COMMUNITY.ORG/LEGAL/ACQUIS.HTML |
| PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA | Ky Ligj është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018-2030, Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021-2030, Planin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2022-2024 dhe Planin Analitik të Akteve 2023. https://eurlex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32017R1369; HTTPS://WWW.ENERGY-COMMUNITY.ORG/LEGAL/ACQUIS.HTML |
| DATA E KONSULTIMIT PUBLIK | 15/11/2023-13/12/2023 |
| DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT | 19.03.2024 |
| A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT | Po, Datë 19.12.2023 |
| NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT | 2024 – MIE- 1 |
| TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT) | Bledar Aliaj; Bledar.Aliaj@infrastruktura.gov.al Mob: 0685001400 |
| PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe) | |
| <p>Në kuadër të procesit të integritimit Evropian, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si autoritet përgjegjës për të ndërmarrë iniciativa ligjvënëse bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, kërkesave të MSA-së në sektorin e energjisë, të cilat përcaktohen në nenin 107 të saj dhe traktatin e nënshkruar rajonal të Komunitetit të Energjisë, ka</p> | |

ndërmarrë iniciativën për të propozuar hartimin e ligjit të ri për etiketimin e produkteve me ndikim në energji i cili plotëson kuadrin ligjor në fushën e efikasitetit të energjisë. Efikasiteti i energjisë është një element thelbësor i Kornizës së Politikave të Klimës dhe Energjisë të Bashkimit Evropian për vitin 2030 dhe është principi kyç për moderimin e kërkesës për energji.

Politika e re për hartimin e kuadrit ligjor për etiketimin e energjisë iniciohet si pasojë e shfuqizimit të Direktivës 2010/30/BE dhe si rrjedhojë edhe shfuqizimit të ligjit 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji” me qëllim angazhimin e Republikës së Shqipërisë për të qënë pjesë e qasjes proaktive, në mënyrë specifike për të hartuar një ligj të ri në fushën e etiketimit të produkteve me ndikim në energji në përputhje me Direktivën 2017/1369/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 14 Korrik 2017 që përcakton kornizën për etiketimin e energjisë dhe shfuqizon Direktivën 2010/30/BE.

Nisma ligjore ndërmerret edhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2018-2030, Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021-2030, Planin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2022-2024 dhe Planin Analitik të Akteve 2023.

Rishikimi i kësaj politike vjen edhe si rezultat i domosdoshmërisë së rregullimit të kuadrit legjislativ për etiketimin e energjisë, nisur nga rekomandimet e ndryshme të organizmave ndërkombëtarë, si: Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian dhe Këshilli dhe Komuniteti i Sekretariatit të Energjisë i cili ka miratuar me anë të Vendimit të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë/2018/3/MC-EnC, përshtatjen dhe zbatimin e Rregullores (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për vendosjen e një kuadri ligjor për etiketimin e energjisë

Politika e re ka për qëllim vënien në dispozicion të informacionit mbi konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera, të produkteve me ndikim në energji për konsumatorin fundor. Ky projektligj synon vendosjen në treg ose në shërbim të produkteve me ndikim në energji dhe dhënien e informacionit standard të tyre në lidhje me efikasitetin e energjisë, konsumin e energjisë dhe të burimeve të tjera gjatë përdorimit, duke u mundësuar kështu blerësve fundorë që të zgjedhin produkte më efikase në mënyrë që të reduktojnë konsumin e tyre të energjisë.

Kjo politikë përcakton kuadrin ligjor për arritjen e objektivave kombëtare për efikasitetin e energjisë, informimin e konsumatorit fundor dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve me ndikim në energji është përgatitur në mbështetje të Planit Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2022-2024 dhe Planit Analitik të Akteve për vitin 2023.

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Kuadri ligjor në fuqi në fushën e etiketimit të produkteve me ndikim në energji është hartuar mbi bazën e transpozimit të Direktivës së Etiketimit të Energjisë 2010/30/BE, miratuar nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian në maj 2010, e cila është shfuqizuar në vitin 2017 me miratimin e Rregullores Nr. 2017/1369 së Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 4 korrik 2017 “Për Etiketimin e Energjisë”. Si rrjedhim, legjislativi vendas në fuqi nuk është në koherencë me standardet aktuale të etiketimit të energjisë për produktet me ndikim në energji të përcaktuara nga rregullorja (EU) 2017/1369.

Zëvendësimi i Direktivës 2010/30/BE (si rrjedhim edhe i ligjit 68/2012) me Rregulloren (EU) 2017/1369 nga Bashkimi Evropian konsiston në thelb në të njëjtën fushëveprimi, por modifikon dhe përmirëson disa nga dispozitat e saj për të sqaruar dhe përditësuar përmbajtjen e tyre, duke marrë parasysh progresin teknologjik lidhur me efikasitetin e energjisë së produkteve me ndikim në energji të prodhuara gjatë viteve të fundit. Kjo rregullore e cila ka zgjeruar gamën e produkteve me ndikim në energji në sektorët tregtarë dhe industrial si dhe ka përcaktuar, azhurnuar rregullat lidhur me markimin, konformitetin dokumentat teknik shoqëruar të produkteve me ndikim në energji dhe ka ripërkufizuar klasat e energjisë së tyre. Si rezultat i zhvillimit të produkteve gjithnjë e më efikase në energji, klasat e energjisë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi A (A+, A++ dhe A+++) në etiketat e produkteve në treg do të ndryshohen. Rregullorja e re BE-së për etiketimin e energjisë përcakton një shkallë të re krahasuese për klasat e energjisë nga A (më efikase) në G (më pak efikase). Etiketimi i energjisë se produkteve të vendosura në treg është një shtytës kryesor për të ndihmuar konsumatorët të zgjedhin produkte që janë më shumë efikase në konsumin e energjisë si dhe inkurajon prodhuesit të nxisin inovacionin duke përdorur teknologji më efikase për prodhimin e këtyre produkteve.

Furnizuesit dhe tregtarët do të përmbushin detyrimet e përcaktuara në këtë nismë ligjore lidhur me vendosjen apo shfaqjen e etiketave, markave, simboleve apo mbishkrimeve të tjera dhe do të vendosin në treg dhe/ose në shërbim produkte me ndikim në energji në përputhje me këto karakteristika.

Duhet theksuar se referuar fushës së zbatimit të ligjit aktual, produktet e përdorura të importuara nga vende jashtë BE-së, nuk janë objekt trajtimi nga legjislacioni në fuqi.

Nga pikëpamja e implementimit të ligjit 68/2012, Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut është përgjegjës, ndër të tjera edhe për inspektimin e zbatimit të legjislacionit parësor dhe dytësor në fushën e etiketimit të energjisë për produktet me ndikim në energji. Për ecurinë e këtij procesi është përgjegjës Sektori i Produkteve Elektrike i cili aktualisht ka kryer dhe raportuar një sërë inspektimesh vjetore të pajisjeve elektrike por nuk janë raportuar të dhëna specifike që nga hyrja në fuqi e ligjit 68/2012 lidhur me etiketimin e produkteve me ndikim në energji të vendosura në treg. Pjesa më e madhe e kësaj kategorie produktesh janë të importuara dhe problemi aktualisht ndërlikohet edhe me tej si pasojë e ndryshimeve të sipërpërmendura të etiketave në treg të cilat nuk janë në koherencë me legjislacionin në fuqi, dhe procesi i inspektimit të këtyre produkteve në treg është aktualisht i pamundur.

Në raportet e fundit të BE-së për Shqipërinë¹, rekomandohet të "vazhdohet puna për miratimin e rregulloreve të etiketimit të energjisë, në përputhje me Direktiven 2017/1369/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 14 Korrik 2017 që përcakton kornizën për etiketimin e energjisë".

Gjithashtu edhe në raportin e fundit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për Shqipërinë² evidentohet se mbetet thelbësore dhe në pritje harmonizimi i kuadrit kombëtar për etiketimin e energjisë me kërkesat më të fundit të Komunitetit të Energjisë.

¹ Raporti i BE-së EECG112021_AL për vitin 2023

²<https://www.energy-community.org/implementation/report/Albania.html>

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat e synuara që duhet të arrihen përmes kësaj politike mund të përmbliken si:

1-Ndjekja e objektivave afatgjata të BE-së për arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050 përmes Marrëveshjes së Parisit dhe “Marrëveshjes së Gjelbër” si detyrim i Shqipërisë që aderohet të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian;

2-Reduktimi i konsumit të energjisë përmes masave të efikasitetit me 8.4% në përputhje me objektivat e përcaktuara në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) 2020-2030.

3- Harmonizimi i legjislacionit aktual me Direktiven 2017/1369/EU për përcaktimin e kornizës së etiketimit të energjisë brenda vitit 2024;

4-Garantimi i të drejtave të konsumatorëve nëpërmjet vendosjes në dispozicion të informacionit standard mbi konsumin e energjisë të produkteve me ndikim në energji dhe të burimeve të tjera gjatë përdorimit, brenda vitit 2025;

6-Legjislacioni shqiptar të jetë në përputhje me standardet dhe legjislacionin e BE-së, duke rritur kështu aftësinë e Shqipërisë për të marrë përsipër detyrimet e saj të anëtarësimit.

7-Zhvillim i politikave konkurruese duke u mundësuar industrive të prodhojnë dhe subjekteve tregtare të tregtojnë produkte më efikente duke fituar një avantazh konkurrues;

8-Nxitja e inovacionit teknologjik dhe investimeve në drejtim të efikasitetit të energjisë.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dezavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së Objektivit të Qeverisë për përafrimin e legjislacionit me acquis në fushën e etiketimit të energjisë për produktet me ndikim në energji:

“Opsioni 0 - status quo” – Ruajtja e situatës aktuale lidhur me vënien në dispozicion të informacionit mbi energjisë të konsumatorit fundor, nëpërmjet etiketave të produkteve me ndikim në energji sipas përcaktimeve në Ligjin 68/2012, duke mos ndërhyrë me nisma legjislative.

“Opsioni 1” – Të ndërhyhet në ligjin aktual në fuqi për azhurnimin e kritereve të vendosjes së etiketave të produkteve me ndikim në energji sipas kritereve që përcakton rregullorja 2017/1369.

“Opsioni 2” – Hartimi i një ligji të ri, i cili do të përmirësojë ligjin aktual dhe do të krijojë një bazë të mirë për miratimin e akteve nënligjore në fushën e etiketimit për produktet me ndikim në energji në përputhje me Rregulloren 2017/1369/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 14 Korrik 2017 që përcakton kornizën për etiketimin e energjisë dhe shfuqizon Direktivën 2010/30/BE duke shfuqizuar Ligjin Nr. 68/2012 “Për informacionin e

konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji” i cili ka transpozuar këtë të fundit.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuara dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuara mbi buxhetin dhe bizneset.

Nga shqyrtimi i këtyre opsioneve, opsioni i preferuar, është “opsioni 2”.

Kjo politikë inicohet me angazhimin e Republikës së Shqipërisë për të qenë pjesë e qasjes proaktive që të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet që synojnë të bëhen pjesë e Komunitetit Evropian kanë në një përgjigje të përbashkët ndërkombëtare ndaj efikasitetit të energjisë dhe ndryshimeve klimatike, gjithnjë e më tepër prezente dhe shqetësuese, në mënyrë specifike për të përafuar plotësisht ligjin e ri me Rregulloren 2017/1369/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 Korrik 2017 që përcakton kornizën për etiketimin e energjisë dhe shfuqizon Direktivën 2010/30/BE.

Qeveria planifikon të ndërhyjë me qëllimin për të plotësuar dhe njëzuar kuadrin ligjor në fushën e efikasitetit për të informuar konsumatorët fundorë mbi konsumin e energjisë së produkteve me ndikim në energji edhe për miratimin e akteve nënligjore të përditësuara.

Qeveria nëpërmjet kësaj nisme synon ndërmarrjen e hapave konkret drejt politikës klimatike në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër dhe Marrëveshjen e Parisit sipas objektivave kombëtare të përcaktuara për efikasitetin e energjisë deri në vitin 2030 në PKEK. Efikasiteti e energjisë është një element thelbësor i Kornizës së Politikave të Klimës dhe Energjisë, të Bashkimit për vitin 2030 dhe është kyç për moderimin e kërkesës për energji.

Ndërhyrja e Qeverisë lidhet me përcaktimin e rregullave ligjore për ti ofruar konsumatorëve fundorë mundësinë që të bëjnë zgjedhje të informuara bazuar në konsumin e energjisë të produkteve të lidhura me energjinë. Informacioni mbi produktet efikasitet të lidhura me energjinë jep një kontribut të rëndësishëm në kursimin e energjisë dhe në reduktimin e faturave të energjisë, ndërsa në të njëjtën kohë promovon inovacionin dhe investimet në prodhimin e produkteve më efikasitet në energji.

Politika e re ka përafuar plotësisht Rregulloren 2017/1369/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 Korrik 2017 dhe do të përbëjë një kontribut konkret të Qeverisë Shqiptare për mbështetjen e një politike kombëtare për të informuar konsumatorët fundorë mbi konsumin e energjisë së produkteve me ndikim në energji dhe gjen mbështetje edhe në dokumentet kryesor strategjikë të sektorit energjistik, siç janë Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030 dhe Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës 2021-2030.

Politika e re përcakton kuadrin ligjor mbi detyrimet që aplikohen për produktet me ndikim në energji të vendosura në treg ose të vëna në shërbim, duke mundësuar që përdoruesit fundorë (blerësit fundorë) të informohen mbi produktet me ndikim në energji lidhur me sa më poshtë:

- a) etiketimin e produkteve nga pikëpamja e konsumit të energjisë;
- b) dhënien e informacionit standard të produktit mbi efikasitetin e energjisë;
- c) konsumin e energjisë dhe konsumin e burimeve të tjera gjatë përdorimit;
- d) informacion plotësues mbi produktin.

Zbatimi i politikës së re, sjell përfitim për të gjithë:

- e) Konsumatorët fundorë familiarë përmes informimit mbi konsumin e energjisë për produktet me ndikim në energji të vendosura në treg ose të vëna në shërbim;

- f) Tregtarët dhe furnizuesit përmes shtrirjes së konkurrencës në tregtimin e produkteve me ndikim në energji përveçse në aspektin ekonomik (çmimi më i ulët) ashtu dhe në aspektin e ciklit jetësor të produktit (që përfshin koston fillestare ashtu dhe koston për përdorimin dhe mirëmbajtjen);
- g) Institucionet publike ku garantohet realizimi i procedurave të prokurimit publik në përputhje me Ligjin e efikasitetit të energjisë, neni 9 “Masat për efikasitetin e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike”;
- h) Bizneset nëpërmjet prodhimit dhe vënies në treg dhe nxitjes së inovacionit në industrinë prodhuese të këtyre produkteve.

Gjithashtu ndikimet parashikohet të sjellin reduktimin e konsumit final bruto të energjisë elektrike në vend dhe si rrjedhim edhe në shpenzimet e blerjes së energjisë në tregun e liberalizuar. Përveç kësaj do të kontribuojë në reduktimin e gazeve me efekt serrë në atmosferë, sigurinë e furnizimit ose optimizimit të prodhimit të energjisë.

Në kuptim të kostos, Opsioni 1 dhe Opsioni 2 ofrojnë të njëjtin efekt në përputhje edhe me kushtet që paraqet realiteti ligjor i sotëm, ndërkohë që Opsioni 0 nuk është i mundur sa kohë që politika e re, e cila ka zgjeruar gamën e produkteve me ndikim në energji në sektorët tregtarë dhe industrial si dhe ka azhurnuar rregullat lidhur me markimin, konformitetin dokumentat teknik shoqëruar të produkteve me ndikim në energji dhe ka ripërkufizuar klasat e energjisë së tyre.

Shqipëria duhet të ndryshojë legjislacionin në fushën e etiketimit të energjisë të produkteve me ndikim në energji pasi ka detyrime për përafrimin e legjislacionit me direktivat përkatëse të BE në përgjithësi dhe, veçanërisht në fushën e efikasitetit të energjisë, ndryshimet bëhen më imediate edhe për shkak të implementimit të Marrëveshjes së Gjellbër dhe Marrëveshjes së Parisit. Në përfundim, Opsion 2 i preferuar sjell dobinë më të lartë afatgjatë, në kuptim të kostos dhe të kthimit përkatës për shkak të qëndrueshmërisë në terma afatgjatë të ligjit. Po kështu, kosto e njohjes me ligjin e ri është më e ulët pasi vetë procesi i njohjes së një ligji të ri intergral është me eficient.

Analiza e ndikimeve të opsionit të preferuar duhet të përfshijë një vlerësim të hollësishëm të ndikimeve të propozimit në buxhet dhe bizneset në lidhje me ligjin për etiketimin e energjisë së produkteve me ndikim në energji. Këtu janë disa aspekte që mund të përfshihen në këtë analizë:

i) *Ndikimet e mundshme financiare :*

Zbatimi i politikës së re, sjell përfitim për konsumatorët fundor, institucionet publike dhe të gjithë sektorët e ekonomisë si rezultat i ndërgjegjësimit mbi konsumin e energjisë të produkteve në dispozicion.

j) **Për Buxhetin:** Zbatimi i Ligjit nuk ka efekte buxhetore të rëndësishme.

k) **Institucionet publike:** Realizimi i procedurave të prokurimit publik në përputhje me Ligjin “Për Efikasitetin e Energjisë”, neni 9, “Masat për efikasitetin e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike” do të reduktojë konsumin final të energjisë dhe do të ndikojnë në reduktimin e faturave të energjisë në terma afatgjatë;

l) **Operatorët Ekonomikë/Biznesi:**

1. **Kostot e Pajtitimit:** Bizneset mund të përjetojnë shpenzime të konsiderueshme për të përmbushur rregulloret e etiketimit të energjisë. Kjo përfshin kosto të lidhura me ridizajnimin e produkteve për të përmbushur standardet e efikasitetit të energjisë, kryerjen e

procedurave të testimit dhe certifikimit dhe përditësimin e materialeve të etiketimit dhe marketingut për të përmbushur kërkesat e reja. Këto shpenzime mund të ndryshojnë në varësi të kompleksitetit të produktit dhe shtrirjes së ndryshimeve rregullative.

2. **Investimi në Kërkim dhe Zhvillim:** Rregulloret mbi etiketimin e energjisë shpesh nxisin bizneset të investojnë më shumë në kërkim dhe zhvillim për të inovuar dhe zhvilluar produkte të energjisë efikase që përmbushin ose kalojnë standardet. Ndërsa investimi në kërkim-zhvillim mund të jetë i kostueshëm në afat të shkurtër, ai mund të çojë në konkurrueshmëri afatgjatë dhe avantazh tregu duke ofruar produkte inovative që i pëlqejnë konsumatorëve të ndërgjegjshëm për mjedisin. Për shkak të veçantisë së kësaj analize dhe lidhjes rast pas rasti me nevojën e bizneseve për t'u pajtuar me ligjin e ri, e kemi të pamundur të bëjmë një vlerësim qoftë edhe të përafërt të kostove të mundshme.
3. **Diferencimi në treg:** Kompanitë që investojnë proaktivisht në zhvillimin e produkteve energjitisht efikase mund të fitojnë avantazh konkurrues në treg. Etiketimi i energjisë mund të shërbejë si një mjet marketingu, duke lejuar bizneset të diferencojnë produktet e tyre bazuar në performancën e efikasitetit të energjisë. Kjo mund të tërheqë konsumatorët e ndërgjegjshëm për mjedisin që përparojnë qëndrueshmërinë, duke çuar në rritje të pjesës së tregut dhe mundësive të të ardhurave.
4. **Kërkesa e konsumatorëve dhe strategjitë e çmimit:** Me rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për efikasitetin e energjisë për shkak të etiketimit të energjisë, bizneset mund të duhet të përshtaten strategjitë e tyre të çmimit. Ndërsa produktet energjitisht efikase mund të kërkojnë një çmim premium për shkak të vlerës së tyre dhe kostove më të ulëta operative, bizneset duhet të menaxhojnë kujdesshëm çmimin për të mbetur konkurrues në treg dhe për të siguruar qasjen për një gamë të gjerë të konsumatorëve.
5. **Humbjet e mundshme të të ardhurave për shkak të mos-pajtimin me rregullat:** Mos-pajtimi me rregulloret e etiketimit të energjisë mund të rezultojë në gjoba, penale ose përgjegjësi ligjore për bizneset. Përveç pasojave financiare të drejtpërdrejta, mos-pajtimi mund të dëmtojë reputacionin dhe imazhin e markës së një kompanie, duke çuar në humbje të mundshme të besimit të konsumatorëve dhe të pjesës së tregut. Prandaj, investimi në masa për përputhjen me legjislacionin është i domosdoshëm për të shmangur ndikimet e tilla financiare negative.

m) Ndikimet sociale

1. **Përforcimi i konsumatorit:** Etiketimi i energjisë fuqizon konsumatorët të bëjnë zgjedhje të ndërgjegjshme në lidhje me mjedisin, duke potencialisht nxitur kulturën e qëndrueshmërisë. Në këtë mënyrë projektligji pritet të ketë një ndikim social pozitiv duke garantuar që konsumatorët të mund të krahasojnë produkte të ndryshme jo vetëm përmes vlerës monetare por edhe përmes performancës energjetike duke konsideruar përfitimet afatgjatë që vijnë si rezultat i një kërkese më të vogël për energji.

2. **Shëndeti publik:** Pajisjet energjitisht efikase mund të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit brenda ambienteve dhe në reduktimin e ekspozimit ndaj emetimeve të dëmshme, duke përfituar shëndetin publik.
3. **Konsiderata për barazinë:** Mund të ketë shqetësime për barazinë sociale nëse produktet energjitisht efikase janë të kushtueshme, duke krijuar potencialisht pengesa për qasjen e shtëpive me të ardhura të ulëta. Megjithatë, kjo mund të lehtësohet përmes politikave si subvencionet ose stimujt për produkte energjitisht efikase. Ligji parashikon që gjatë zbatimit të skemave për nxitjen e blerjeve të produkteve të specifikuara në aktet ligjore dhe nënligjore me subvencionim nga buxheti i shtetit, do të realizohen duke synuar dy klasat më të larta të efikasitetit të energjisë, të disponueshme gjërisht, ose klasat më të larta siç përcaktohet në aktet nënligjore për produkte specifike.

n) Ndikimet mjedisore

1. **Ndërgjegjësim për efikasitetin energetik:** është një element thelbësor i kornizës së Politikave të Klimës të Bashkimit për vitin 2030 dhe është kyç për moderimin e kërkesës për energji përfshirë zvogëlimin e emetimeve të gazeve me efekt serë. Etiketimi i energjisë rrit ndërgjegjësimin e konsumatorëve në lidhje me konsumin e energjisë të produkteve, duke çuar në zgjedhje të informuara që mund të shtyjnë kërkesën drejt opsioneve më të efikasëm në energji.
2. **Ulja e konsumit të energjisë:** Me informacion më të qartë për efikasitetin e energjisë, konsumatorët mund të zgjedhin produkte energjitisht më efikase, duke çuar në uljen të konsumit të energjisë dhe emetimit të gazrave ndotës.
3. **Nxitja e Inovacionit:** Rregullimet më të ashpra për etiketimin e energjisë mund të nxisin prodhuesit të inovojnë dhe të zhvillojnë teknologji energjitisht më efikase për të përmbushur standarde më të larta.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i preferuar është opsioni 2, sepse:

1-Legjislacioni i ndryshuar do të përforcojë lidhjen midis objektivit të kuadrit rregullator dhe objektivave të përgjithshme politike të qeverisë shqiptare.

Hartimi i një politike të re për etiketimin e energjisë është në përputhje me kërkesat e MSA-së në sektorin e energjisë, të cilat përcaktohen në nenin 107 të saj dhe me acquis të miratuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë me Vendimin e Këshillit Ministror Të Komunitetit Të Energjisë DI201813IMG-EnC dhe në kuadër të procesit të integritimit Evropian dhe do të krijojë një bazë ligjore në fushën etiketimit për produktet me ndikim në energji në përputhje me Rregulloren 2017/1369/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit

e datës 14 Korrik 2017 që përcakton kornizën për etiketimin e energjisë dhe plotëson kuadrin ligjor në fushën e efikasitetit të energjisë.

Politika e re për hartimin e kuadrit ligjor për etiketimin e energjisë inicihet si pasojë e shfuqizimit të Direktivës 2010/30/BE dhe si rrjedhojë edhe shfuqizimit të ligjit 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji” me qëllim angazhimin e Republikës së Shqipërisë për të qënë pjesë e qasjes proaktive, në mënyrë specifike për të hartuar një ligj të ri në fushën e etiketimit të produkteve me ndikim në energji në përputhje me Direktivën 2017/1369/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 14 Korrik 2017 që përcakton kornizën për etiketimin e energjisë dhe shfuqizon Direktivën 2010/30/BE.

Hyrja në fuqi e projekt-ligjit për etiketimin e produkteve me ndikim në energji duke shfuqizuar Ligjin në fuqi Nr. 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”, do të kontribuojë në formimin e kuadrit ligjor për mbështetjen e një politike kombëtare për të informuar konsumatorët fundorë mbi konsumin e energjisë së produkteve me ndikim në energji, dhe në krijimin e një baze më të mirë ligjore për miratimin e akteve nënligjore të rëndësishme për zbatimin efektiv të kësaj nisme ligjore. Informacioni mbi produktet efikente të lidhura me energjinë jep një kontribut të rëndësishëm në kursimin e energjisë dhe në reduktimin e faturave të energjisë, ndërsa në të njëjtën kohë promovon inovacionin dhe investimet në prodhimin e produkteve më efikente në energji. Duhet theksuar se përveç produkteve të vendosura në tregun Shqiptar për herë të parë, objekti i këtij projektakti zgjerohet edhe me përfshirjen e produkteve të perdorura përveçse kur importohen.

Rekomandime të vijueshme të organizmave ndërkombëtare të cilat auditojnë dhe monitorojnë në mënyrë permanente sektorin e efikasitetit të energjisë konsistojnë në nevojën e përcaktimit nga ana e shtetit të mekanizmave ligjore të pershtatshme, të cilat do të mundësojnë konsumatorit shqiptar informacionin e nevojshëm mbi konsumin e pajisjeve me ndikim në energji sipas qasjeve me të fundit të tregut evropian.

Unifikimi i këtij informacioni me tregjet homologe evropiane, për sa i përket klasave të energjisë së produkteve me ndikim në energji do të ndihmojë konsumatorët shqiptar për të disponuar informacionin e azhurnuar mbi konsumin e këtyre produkteve që ofron tregu, informacioni i cili do të ndikojë në uljen e konsumit të energjisë në nivel konsumatori dhe për rrjedhim në uljen e faturave të paguara për konsumin e saj, nga ana e tyre.

Kjo nismë, pra hartimi i një ligji të ri për etiketimin e produkteve me ndikim në energji, nuk sjell kosto shtesë në Buxhetin e Shtetit.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

| Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 |
|--------|--------|--------|
| 0 | 0 | 0 |

Ky projektligj nuk ka kosto mbi buxhetin e shtetit

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Së pari, duhet mbajtur parasysh se kjo nismë është ndërmarrë nga Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë nisur nga rekomandimet e ndryshme të organizmave ndërkombëtarë, si: Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian dhe Këshilli dhe Komuniteti i Sekretariatit të Energjisë i cili ka miratuar me anë të Vendimit të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë/2018/3/MC-EnC, përshtatjen dhe zbatimin e Rregullores (BE) 2017/1369 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit për vendosjen e një kuadri ligjor për etiketimin e energjisë.

Së dyti, kjo nismë ligjore është konsultuar me ministrinë e linjës dhe aktualisht janë reflektuar sugjerimet e paraqitura deri më tani.

Së treti, kjo nismë ligjore, si cdo akt tjetër është konsultuar me palët e tjera të interesuara në kuadrin e procedurës së konsultimit publik. Njoftimi është afishuar në RENJKP dhe në faqen zyrtare të MIE-s prej datës 15 Nëntor 2023, ku janë ftuar grupet e interesit të dërgojnë komentet/rekomandimet brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e konsultimit publik. Procesi i konsultimit është mbyllur në datën 13.12.2023 dhe shikueshmëria në RENJKP ka arritur një nr prej 84 personash dhe nuk ka pasur komente nga grupet e interesit.

Linku: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/680>

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

- Ministria përgjegjëse për ekonominë nëpërmjet strukturave të saj të varësisë.
- Inspektoratit Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut inspekton përputhjen e produkteve të vendosura në treg me kërkesat e kësaj nisme ligjore.

Gjithashtu, për zbatimin e opsionit të preferuar do të ngarkohen edhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe autoritetet doganore.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, (MIE) është institucioni kombëtar përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e politikave në fushën e efijencës së energjisë.
- Inspektorati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut është përgjegjës për monitorimin e Etiketimit të produkteve me ndikim në energji dhe kryen vlerësimin e zbatimit të kësaj politike në praktikë. ISHMT përgatit programin vjetor të inspektimit dhe një kopje të rezultateve vjetore e dërgon pranë MIE mbi plotësimin e objektivave që parashikon duke raportuar me tej pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Kuadri ligjor në fuqi në fushën e etiketimit të produkteve me ndikim në energji është hartuar mbi bazën e transpozimit të Direktivës së Etiketimit të Energjisë 2010/30/BE, miratuar nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian në maj 2010, e cila është shfuqizuar në vitin 2017 me

miratimin e Rregullores Nr. 2017/1369 së Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 4 korrik 2017 “Për Etiketimin e Energjisë”.

Ky ligj përcakton detyrimet që aplikohen për produktet me ndikim në energji të vendosura në treg ose të vëna në shërbim, në lidhje me:

- a) etiketimin e tyre nga pikëpamja energjetike;
- b) dhënien e informacionit standard të produktit mbi efikasitetin e energjisë;
- c) konsumin e energjisë dhe konsumin e burimeve të tjera gjatë përdorimit;
- d) informacion plotësues mbi produktin,

duke mundësuar që përdoruesit e fundit (blerësit fundorë) të zgjedhin produkte më efikente, me qëllim reduktimin e konsumit të tyre të energjisë.

Ligji 68/2012, nuk ka patur ndryshime deri me tani. Ky ligj përcakton detyrimet për informimin e përdoruesve të fundit të produkteve që kanë një ndikim në energji dhe, sipas rastit, burimeve të tjera kryesore të produkteve, që, gjatë përdorimit të tyre, kanë ndikim në konsumin e energjisë.

Ky ligj zbatohet për produkte që gjatë përdorimit kanë një ndikim të rëndësishëm, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, mbi konsumin e energjisë dhe, sipas rastit, mbi burimet e tjera kryesore.

2. Ky ligj nuk zbatohet për:

- a) produktet e përdorura;
- b) çdo mjet transporti për persona ose mallra;
- c) pllakëzat që tregojnë parametrat e produktit ose të njëvlerëshmet e tyre, të fiksuara në produkt, për qëllime të sigurisë.

Në zbatim të Ligjit 68/2012 janë miratuar në mënyrë periodike edhe legjislacioni dytësor si më poshtë:

- VKM Nr. 928, datë 19.12.2012 “Për miratimin e rregullit teknik “Për etiketimin e makinave larëse për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e Energjisë”;
- VKM Nr. 929, datë 19.12.2012 “Për miratimin e rregullit teknik “për etiketimin e pajisjeve frigoriferike për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë”;
- VKM Nr. 296, datë 3.4.2013 “Për miratimin e rregullit teknik “për informacionin e tharëseve për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë”;
- VKM Nr. 865, datë 21.10.2015 “Për miratimin e Rregullores Teknike të Etiketimit të Energjisë së Kondicionerëve”;
- VKM Nr.1059 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat e efikasitetit të droselave për ndriçim fluoreshent”;
- VKM Nr. 1064, datë 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për kërkesat e efikasitetit për bojlerët e ujit që përdorin lëndë djegëse të lëngët ose të gaztë’ dhe përcaktimin e listës së standarteve të harmonizuara”;
- VKM Nr 480 datë 03.06.2015 “Për miratimin e rregullave teknike për aparatet marrëse televizive, që do të vendosen në treg”;

- VKM Nr.942, datë 28.12.2016 “Për miratimin e rregullit teknik “Për etiketimin e energjisë së llambave dhe të ndriçuesve elektrikë”;
- VKM Nr. 191, datë 4.4.2018 “Për miratimin e rregullit teknik “për etiketimin e energjisë për furrat shtëpiake dhe aspiratorët thithës”1 vendim nr. 191, datë 4.4.2018 për miratimin e rregullit teknik “për etiketimin e energjisë për furrat shtëpiake dhe aspiratorët thithës”;
- VKM Nr. 378, datë 5.6.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”;
- VKM Nr. 552, datë 31.07.2019, “Për miratimin e rregullit teknik “Për përputhshmërinë elektromagnetike të pajisjeve dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problemi në shqyrtim lidhet me kuadrin ligjor aktual, i cili nuk është në koherencë me kornizën e re rregullatore të BE-së në fushën e etiketimit të produkteve me ndikim në energji. Ligji në fuqi është hartuar mbi bazën e transpozimit të Direktivës së Etiketimit të Energjisë 2010/30/BE, miratuar nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian në maj 2010, e cila është shfuqizuar në vitin 2017 me miratimin e Rregullores Nr. 2017/1369 së Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 4 korrik 2017 “Për Etiketimin e Energjisë”. Si rrjedhim, legjislacioni vendas në fuqi nuk është në koherencë me standardet aktuale të etiketimit të energjisë për produktet me ndikim në energji të përcaktuara nga rregullorja (EU) 2017/1369, rregullore e cila ka zgjeruar gamën e produkteve me ndikim në energji në sektorët tregtarë dhe industrial si dhe ka përcaktuar, azhurnuar rregullat lidhur me markimin, konformitetin dokumentat teknik shoqërues të produkteve me ndikim në energji dhe ka ripërkufizuar klasat e energjisë së tyre.

Si rezultat i zhvillimit të produkteve gjithnjë e më efikase në energji, klasat e energjisë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, etiketat e produkteve në treg duhet të ndryshohen. Rregullorja e re BE-së për etiketimin e energjisë përcakton një shkallë të re krahasuese për klasat e energjisë nga A (më efikase) në G (më pak efikase). Etiketimi i energjisë së produkteve të vendosura në treg është një shtytës kryesor për të ndihmuar konsumatorët të zgjedhin produkte që janë më shumë efikase në konsumin e energjisë si dhe inkurajon prodhuesit të nxisin inovacionin duke përdorur teknologji më efikase për prodhimin e këtyre produkteve.

Klasat në etiketat ekzistuese, në varësi të grupit të produkteve kanë shkallë të ndryshme, ku klasa e lartë mund të jetë çdo gjë midis klasave A deri në A+++ , nderkohe që Rregullorja e BE-së në fuqi për etiketimin e energjisë përcakton një shkallë të re krahasuese për klasat e energjisë nga A (më efikase) në G (më pak efikase), gjë që shkatton konfuzion për konsumatorët në treg.

Gjithashtu ligji aktual përjashton detyrimet e etiketimit të produkteve të përdorura të vendosura në treg.

Etiketimi i energjisë së produkteve të vendosura në treg është një shtytës kryesor për të ndihmuar konsumatorët të zgjedhin produkte që janë më shumë eficientë në konsumin e energjisë si dhe inkurajon prodhuesit të nxisin inovacionin duke përdorur teknologji më eficientë për prodhimin e këtyre produkteve.

Si shkakun kryesor të këtij problemi mund të përmendim mungesën e kontrollit të tregut vendas lidhur me etiketimin e produkteve me ndikimne energji për shkak të mungesës së një dispozite ligjore që detyron kompanitë prodhuese për të qënë transparente me publikun në lidhje me konsumin e energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve në produkte i cili krijon pasojat si më poshtë.

Mungesën e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për rëndësinë e përdorimit të energjisë dhe ndikimin që ata kanë në mjedis dhe buxhetin e tyre.

Mungesën e instrumenteve matës për raportimin e zbatimit të përmbushjes së objektivave të politikave të energjisë dhe klimës.

Kompanitë prodhuese duhet të kenë përgjegjësi ligjore për furnizimin me produkte të etiketuara dhe të shoqëruara me informacion të konsumit të energjisë.

Konsumatorët fundorë nuk kanë akses të mjaftueshëm në informacion që mund t'i ndihmojë ata të marrin vendime të informuara në lidhje me përdorimin e energjisë.

Gjithashtu, disa problematika të tjera që konstatojmë në ligjin aktual janë:

- 1)Nuk parashikohet programi vjetor i inspektimit për vitin pasardhës si dhe dërgimin e tij pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë për aprovim mbi pajtueshmërinë më këtë ligj.
- 2)Nuk parashikohet procedura për trajtimin e produkteve që paraqesin rrezik.
- 3)Nuk parashikohet bashkëpunimi me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe Palet kontraktuese për ndryshimin e masave kombëtare për rastet specifike të kundërshtimeve. Kur Sekretariati konsideron se një masë kombëtare është në kundërshtim me ligjin e Komunitetit të Energjisë Sekretariati do të konsultohet pa vonesë me Palën Kontraktuese dhe furnizuesin ose, kur është e përshtatshme, tregtarin dhe do të vlerësojë masën kombëtare.

Grupet e prekura nga problematikat e evidentuara më lart janë:

- 1)Konsumatorët;
- 2)Prodhuesit dhe distributorët;
- 3)Organet rregullatore dhe ligjzbatuese: Agjencitë qeveritare përgjegjëse për zbatimin e rregulloreve të etiketimit;
- 4)Partnerët e Tregtisë Ndërkombëtare;

Këto problematika shtrihen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke prekur të gjithë konsumatorët e energjisë, prodhues, etj, pasi ndikojnë drejtpërdrejtë në mungesën e transparencës, kosto tek të gjithë qytetarët si pasojë e konsumit, në drejtim të pasigurisë dhe paqëndrueshmërisë mjedisore.

Ky problem mund të trajtohet vetëm nëpërmjet harmonizimit të plotë të rregullores së BE-së në fuqi që përcakton kornizën e etiketimit të energjisë.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj nisme është të kontribuojë në arritjen e synimit që Shqipëria të vijojë me arritjen e objektivave kombëtarë të efikasitetit të energjisë dhe plotësimin të kuadrit ligjor në fushën e efikasitetit të energjisë. Nisma propozohet në përmbushje të angazhimeve të shtetit shqiptar që synon anëtarësimin në Bashkimin Evropian, konkretisht përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis communautaire* dhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2018-2030, Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021-2030, Planin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2022-2024 dhe Planin Analitik të Akteve 2023. Strategjia Kombëtare Energjisë 2018-2030 dhe Plani Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021-2030 me objektiva me të azhornuara parashikojnë masa për arritjen e objektivit kombëtar për dimensionin e efikasitetit të energjisë nëpërmjet uljes së konsumit të energjisë. Targeti kombëtar në fuqi deri në vitin 2030 është reduktimi i konsumit të energjisë deri në 8.4%. Politika e re konsiston në plotësimin e bazës ligjore për efikasitetin e energjisë në vend e cila do të kontribuojë në arritjen e objektivit kombëtar të përcaktuar në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) 2020-2030, ku një ndër masat e parashikuara në PKEK është edhe miratimi i këtij projektligji i cili nëpërmjet informimit të konsumatorit fundor do të kontribuojë në uljen e konsumit të energjisë.

Qeveria shqiptare ka transpozuar pjesën me të konsiderueshme të bazës ligjore në fushën e efikasitetit të energjisë dhe reduktimin e gazeve me efekt serra. Ligjet kryesore të miratuara për këtë qëllim janë:

- Ligj Nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë”, të ndryshuar
- Ligj Nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”
- Ligj Nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”

Politika e re për hartimin e kuadrit ligjor për etiketimin e energjisë iniciohet si pasojë e shfuqizimit të Direktivës 2010/30/BE dhe si rrjedhojë edhe shfuqizimit të ligjit 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji” me qëllim angazhimit të Republikës së Shqipërisë për të qënë pjesë e qasjes proaktive, në mënyrë specifike të ndermerret nisma për ndryshimin e politikës në fushën e etiketimit të produkteve me ndikim në energji në përputhje me Direktiven 2017/1369/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 14 Korrik 2017, që përcakton kornizën për etiketimin e energjisë dhe shfuqizon Direktivën 2010/30/BE.

Nisma propozohet në përmbushje të angazhimeve të shtetit shqiptar që synon anëtarësimin në Bashkimin Evropian, konkretisht përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis communautaire* dhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2018-2030,

Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021-2030, Planin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2022-2024 dhe Planin Analitik të Akteve 2023.

Hartimi i kësaj politike vjen edhe si rezultat i domosdoshmërisë së rregullimit të kuadrit legjislativ për etiketimin e energjisë, nisur nga rekomandimet e ndryshme të organizmave ndërkombëtarë, si: Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian dhe Këshilli dhe Komuniteti i Sekretariatit të Energjisë i cili ka miratuar me anë të Vendimit të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë/2018/3/MC-EnC, përshtatjen dhe zbatimin e Rregullores (BE) 2017/1369 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit për vendosjen e një kuadri ligjor për etiketimin e energjisë.

Politika e re synon arritjen e objektivave kombëtare për efikasitetin e energjisë, informimin e konsumatorit fundor dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve me ndikim në energji është përgatitur në mbështetje të Planit Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2022-2024 dhe Planit Analitik të Akteve për vitin 2023.

Si rezultat i zhvillimit të produkteve gjithnjë e më efikase në energji, klasat e energjisë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi A (A+, A++ dhe A+++)) në etiketat e produkteve në treg do të ndryshohen. Rregullorja e re BE-së për etiketimin e energjisë përcakton një shkallë të re krahasuese për klasat e energjisë nga A (më efikase) në G (më pak efikase). Etiketimi i energjisë se produkteve të vendosura në treg është një shtytës kryesor për të ndihmuar konsumatorët të zgjedhin produkte që janë më shumë efikase në konsumin e energjisë si dhe inkurajon prodhuesit të nxisin inovacionin duke përdorur teknologji më efikase për prodhimin e këtyre produkteve.

Për të shmangur një konfuzion të tillë të mundshëm, është e përshtatshme të kryhet, një rishkallëzim fillestar i etiketave ekzistuese, në mënyrë që të sigurohet një shkallë homogjene nga A në G për tre kategori produktesh në përputhje me rregullat evropian për vënien në dispozicion të një informacioni të unifikuar nëpërmjet rishkallëzimit të etiketave.

Gjithashtu ligji aktual përjashton produktet e përdorura të vendosura në treg përveçse kur importohen, gjë që përbën problem nëse i referohemi produkteve të përdorura të vendosura aktualisht në treg nga vende jashtë Bashkimit Evropian, etiketimi i të cilave nuk është i rregulluar nëpërmjet legjislacionit evropian për etiketimin.

Objektivi i politikës

Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.

Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.

Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.

Efienca i energjisë është një element thelbësor i Kornizës së Politikave të Klimës dhe Energjisë të Bashkimit Evropian për vitin 2030 dhe është objektivi kryesor për moderimin e kërkesës për energji.

1-Ndjekja e objektivave afatgjata të BE-së për arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050 përmes Marrëveshjes së Parisit dhe “Marrëveshjes së Gjelbër” si detyrim i Shqipërisë që aderon të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian;

2- Reduktimi i konsumit të energjisë përmes masave të efikasitetit me 8.4% në përputhje me objektivat e përcaktuara në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) 2020-2030.

3- Harmonizimi i legjislacionit aktual me Direktiven 2017/1369/EU për përcaktimin e kornizës së etiketimit të energjisë brenda vitit 2024;

4- Sigurimi i etiketimit të produkteve me ndikim në energji, brenda vitit 2025;

5-Garantimi i të drejtave të konsumatorëve nëpërmjet vendosjes në dispozicion të informacionit standard mbi konsumin e energjisë të produkteve me ndikim në energji dhe të burimeve të tjera gjatë përdorimit, brenda vitit 2025;

7-Zhvillim i politikave konkurruese duke u mundësuar industrive të prodhojnë dhe subjekteve tregtare të tregtojnë produkte më efikase duke fituar një avantazh konkurrues;

8- Nxitja e inovacionit teknologjik dhe investimeve në drejtim të efikasitetit të energjisë.

Objektivat e Politikave Energjitike janë një çështje e rëndësishme në axhenden politike të vendit. Harmonizimi i plotë i legjislacionit në fushën e energjisë përveçse një detyrim ndërkombëtar për anëtarësimin e vendit në BE përbën edhe një përpjekje për të arritur qëllime të tilla si zvogëlimi i ndotjes së mjedisit, diversifikimi i burimeve të energjisë, përmirësimi i efikasitetit të energjisë, dhe siguria e furnizimit.

Informacioni mbi konsumin e energjisë është një element kontribues i agjendës globale për të luftuar ndryshimet klimatike dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit dhe ujit.

Politikat për efikasitetin e energjisë së produkteve me ndikim në energji janë gjithashtu të lidhura me përpjekjet për të reduktuar konsumin final të energjisë si dhe duke kontribuar për furnizimin e qëndrueshëm me energji.

Në disa raste, këto nisma përqëndrohen në promovimin e inovacionit teknologjik në fushën e efikasitetit të energjisë. Nisma të tilla janë ndërhyrje nga qeveria për të ofruar informacion më të detajuar për konsumatorët të kursejnë energjinë dhe të jenë më të vetëdijshëm për përdorimin e saj.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

“Opsioni 0 - status quo” – Ruajtja e situatës aktuale lidhur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të etiketimit të produkteve me ndikim në energji, duke mos ndërhyrë me nisma legjislative nuk përmbush objektivat e përcaktuara më sipër, si dhe do të krijohej një mospërshtatje e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Europian, pasi Ligji Nr. 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji” nuk do të ishte në përputhje me direktivën e Parlamentit Europian dhe Këshillit 1369/2017.

“Opsioni 1” – Të ndërhyhet me disa ndryshime dhe plotësime në ligjin ekzistues në fuqi 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”. Ndjekja e këtij opsioni nuk do të rezultonte efektiv, pasi ndryshimet dhe shtesat janë të konsiderueshme dhe do të krijonte konfuzion ligjor në kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji. Në kuadër të teknikës legjislative, duke qenë se ndërhyrjet e synuara prekin me shumë se 70% të përmbajtjes së ligjit aktual, opsioni 1 nuk mund të perzgjidhet si opsion i volitshëm pasi do të krijonte konfuzion në kuptueshmërinë dhe qartësinë e kuadrit rregullator.

“Opsioni 2” – Të hartohet një politike e re, i cili do të përditesojë dhe rregullojë kuadrin ligjor në fushën energjisë duke shfuqizuar Ligjin. Nr, 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji. Opsioni 2 duket të jetë më i favorshmi për t’u perzgjedhur pasi nëpërmjet hartimit, miratimit dhe zbatimit të një ligji të ri, sigurohet rregullimi i kësaj fushe në mënyrë shteruese. Gjithashtu, miratimi i një ligji të ri do të mundësojë përshtatjen dhe koherencën me politikat ndërkombëtare mbi çështjen për etiketimin e produkteve me ndikim në energji, zbatimin e Direktivës 2017/1369/EU. Duke miratuar dhe zbatuar një ligj të ri në këtë fushë, Republika e Shqipërisë përmbush gjithashtu detyrimet e saj në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe detyrimet që burojnë nga marrëveshje dhe traktate të tjera ndërkombëtare përkatëse. Miratimi i një ligji të ri rrit edhe qëndrueshmërinë në kohë të politikës së miratuar, si dhe potencialin për zbatim të saktë të saj.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

Bazuar në këtë përmbajtje të politikës së re, grupet që preken nga zbatimi i tij janë si më poshtë:

- Konsumatorët fundorë familjarë përmes informimit mbi konsumin e energjisë për produktet me ndikim në energji të vendosura në treg ose të vëna në shërbim;
- Tregtarët dhe furnizuesit përmes shtrirjes së konkurrencës në tregtimin e produkteve me ndikim në energji përveçse në aspektin ekonomik (çmimi më i ulët) ashtu dhe në aspektin e ciklit jetësor të produktit (që përfshin koston fillestare ashtu dhe koston për përdorimin dhe mirëmbajtjen);

- Institucionet publike ku garantohet realizimi i procedurave të prokurimit publik në përputhje me Ligjin e efikasitetit të energjisë, neni 9 “Masat për efikasitetin e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike”;
- Bizneset nëpërmjet prodhimit dhe vënies në treg dhe nxitjes së inovacionit në industrinë prodhuese të këtyre produkteve.

- *Bizneset dhe Publiku / rezidentet ne RSH.*

- Bizneset/Prodhuesit e produkteve;
- Tregtarët dhe furnizuesit;
- Konsumatorët fundorë;
- Institucionet publike

Ndikimet e Opsionit 2 janë si vijon:

- *Ndikimet ekonomike (përfshirë ato financiare)*

a) Për Buxhetin

Zbatimi i kesaj nisme nuk parashikohet të ketë ndikim mbi buxhetin e shtetit duke konsideruar se struktura përgjegjëse për mbikqyrjen e tregut është funksionale dhe operon në këto fusha që prej vitit 2012. Inspektorati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut është krijuar me VKM nr.36, datë 20.01.2016, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut”. ISHMT është një institucion në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i cili është përgjegjës për inspektimin në fushën e sigurisë së produkteve joushqimore për përdorim nga konsumatorët dhe sektorin e pronësisë intelektuale. Ndër të tjera Inspektorati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut është përgjegjës për inspektimin e zbatimit të legjislativës parësor dhe dytësor në fushën e etiketimit të energjisë për produktet e lidhura me energjinë. Për inspektimin e produkteve me ndikim në energji është përgjegjës Sektori i Produkteve Elektrike.

Në kuptim të kostos, Opsioni 1 dhe Opsioni 2 ofrojnë të njëjtin efekt në përputhje edhe me kushtet që paraqet realiteti ligjor i sotëm, ndërkohë që Opsioni 0 nuk është i mundur sa kohë që politika e re, e cila ka zgjeruar gamën e produkteve me ndikim në energji në sektorët tregtarë dhe industrial si dhe ka azhurnuar rregullat lidhur me markimin, konformitetin dokumentat teknik shoqëruar të produkteve me ndikim në energji dhe ka ripërkufizuar klasat e energjisë së tyre.

Ndër ndikimet e mundshme financiare/ekonomike për bizneset mund të listojmë:

- **Kostot e Pajtitimit:** Bizneset mund të përjetojnë shpenzime të konsiderueshme për të përmbushur rregulloret e etiketimit të energjisë. Kjo përfshin kosto të lidhura me ridizajnimin e produkteve për të përmbushur standardet e efikasitetit të energjisë, kryerjen e procedurave të testimit dhe certifikimit dhe përditësimin e materialeve të etiketimit dhe marketingut për të përmbushur kërkesat e reja. Këto shpenzime mund të ndryshojnë në varësi të kompleksitetit të produktit dhe shtrirjes së ndryshimeve rregullative.
- **Investimi në Kërkim dhe Zhvillim:** Rregulloret mbi etiketimin e energjisë shpesh nxisin bizneset të investojnë më shumë në kërkim dhe zhvillim për të inovuar dhe zhvilluar produkte të energjisë efikase që përmbushin ose kalojnë standardet. Ndërsa

investimi në kërkim-zhvillim mund të jetë i kostueshëm në afat të shkurtër, ai mund të çojë në konkurrueshmëri afatgjatë dhe avantazh tregu duke ofruar produkte inovative që i pëlqejnë konsumatorëve të ndërgjegjshëm për mjedisin. Për shkak të veçantisë së kësaj analize dhe lidhjes rast pas rasti me nevojën e bizneseve për t'u pajtuar me ligjin e ri, e kemi të pamundur të bëjmë një vlerësim qoftë edhe të përafërt të kostove të mundshme.

- **Diferencimi në treg:** Kompanitë që investojnë proaktivisht në zhvillimin e produkteve energjitisht efikase mund të fitojnë avantazh konkurrues në treg. Etiketimi i energjisë mund të shërbejë si një mjet marketingu, duke lejuar bizneset të diferencojnë produktet e tyre bazuar në performancën e efikasitetit të energjisë. Kjo mund të tërheqë konsumatorët e ndërgjegjshëm për mjedisin që përparojnë qëndrueshmërinë, duke çuar në rritje të pjesës së tregut dhe mundësive të të ardhurave.
- **Kërkesa e konsumatorëve dhe strategjitë e çmimit:** Me rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për efikasitetin e energjisë për shkak të etiketimit të energjisë, bizneset mund të duhet të përshtaten strategjitë e tyre të çmimit. Ndërsa produktet energjitisht efikase mund të kërkojnë një çmim premium për shkak të vlerës së tyre dhe kostove më të ulëta operative, bizneset duhet të menaxhojnë kujdesshëm çmimin për të mbetur konkurrues në treg dhe për të siguruar qasjen për një gamë të gjerë të konsumatorëve.
- **Humbjet e mundshme të të ardhurave për shkak të mos-pajtimit me rregullat:** Mos-pajtimi me rregulloret e etiketimit të energjisë mund të rezultojë në gjoba, penale ose përgjegjësi ligjore për bizneset. Përveç pasojave financiare të drejtpërdrejta, mos-pajtimi mund të dëmtojë reputacionin dhe imazhin e markës së një kompanie, duke çuar në humbje të mundshme të besimit të konsumatorëve dhe të pjesës së tregut. Prandaj, investimi në masa për përputhjen me legjislacionin është i domosdoshëm për të shmangur ndikimet e tilla financiare negative.

- *Ndikimet sociale*

Përforcimi i konsumatorit: Etiketimi i energjisë fuqizon konsumatorët të bëjnë zgjedhje të ndërgjegjshme në lidhje me mjedisin, duke potencialisht nxitur kulturën e qëndrueshmërisë. Në këtë mënyrë projektligji pritet të ketë një ndikim social pozitiv duke garantuar që konsumatorët të mund të krahasojnë produkte të ndryshme jo vetëm përmes vlerës monetare por edhe përmes performancës energjetike duke konsideruar përfitimet afatgjatë që vijnë si rezultat i një kërkese më të vogël për energji

Shëndeti publik: Pajisjet energjitisht efikase mund të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit brenda ambienteve dhe në reduktimin e ekspozimit ndaj emetimeve të dëmshme, duke përfituar shëndetin publik.

Konsiderata për barazinë: Mund të ketë shqetësime për barazinë sociale nëse produktet energjitisht efikase janë të kushtueshme, duke krijuar potencialisht pengesa për qasjen e shtëpive me të ardhura të ulëta. Megjithatë, kjo mund të lehtësohet përmes politikave si subvencionet ose stimujt për produkte energjitisht efikase. Ligji parashikon që gjatë zbatimit të skemave për nxitjen e blerjeve të produkteve të specifikuara në aktet ligjore dhe nënligjore me subvencionim nga buxheti i shtetit, do të realizohen duke synuar dy klasat më të larta të

efiçencës së energjisë, të disponueshme gjërësisht, ose klasat më të larta siç përcaktohet në aktet nënligjore për produkte specifike.

- *Ndikimet mjedisore*

Ndërgjegjësim për efikasitetin energetik: është një element thelbësor i kornizës së Politikave të Klimës të Bashkimit për vitin 2030 dhe është kyç për moderimin e kërkesës për energji përfshirë zvogëlimin e emetimeve të gazeve me efekt serë. Etiketimi i energjisë rrit ndërgjegjësimin e konsumatorëve në lidhje me konsumin e energjisë të produkteve, duke çuar në zgjedhje të informuara që mund të shtyjnë kërkesën drejt opsioneve më të efikasëm në energji.

Ulja e konsumit të energjisë: Me informacion më të qartë për efikasitetin e energjisë, konsumatorët mund të zgjedhin produkte energjikiht më efikase, duke çuar në uljen të konsumit të energjisë dhe emetimit të gazrave ndotës.

Nxitja e Inovacionit: Rregullimet më të ashpra për etiketimin e energjisë mund të nxisin prodhuesit të inovojnë dhe të zhvillojnë teknologji energjikiht më efikase për të përmbushur standarde më të larta.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është Opsioni 2.

“Opsioni 2” – Të hartohet një ligj i ri, i cili do të perditesoje dhe rregulloje kuadrin ligjor në fushën energjisë, duke shfuqizuar Ligjin Nr. ligji Nr. 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”

Opsioni 2 duket të jetë më i favorshmi për t’u përzgjedhur pasi nëpërmjet hartimit, miratimit dhe zbatimit të një ligji të ri sigurohet rregullimi i kësaj fushe në mënyrë shteruese.

Gjithashtu, miratimi i një ligji të ri do të mundësojë përshtatjen dhe koherencën me politikat ndërkombëtare mbi çështjen e përdorimit të Etiketimit të produkteve me ndikim në energji, dhe finalizohet transpozimi kombëtar dhe zbatimi i Direktivës 2017/1369/EU. Duke miratuar dhe zbatuar një politikë të re në këtë fushë, Republika e Shqipërisë përmbush gjithashtu detyrimet e saj në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe detyrimet që burojnë nga marrëveshje dhe traktate të tjera ndërkombëtare perkatëse.

Ndryshimet e projektligjit nga ligji aktual në fuqi mund ti përmbledhim si më poshtë:

- a) Ndryshimi i dispozitave lidhur me produktet e përdorura me ndikim në energji.
- Në nenin 3 shtohen disa perkufizime të tjera si “Grup produkti”, “Sistem”, “Model”, “Identifikues modelit”, “Modeli ekuivalent”, “Shitje në distancë”, “Klient”, “Efiçenca e energjisë”, “Standard i harmonizuar”, “Etiketë”, “Rishkallëzimi”, “Etiketë e rishkallëzuar”, “Dokumentacion teknik”, “Informacion plotësues” dhe “tolerancë verifikimi”.

- Shtohen detyrime te tjera per furnizuesit dhe tregtarët.
- Shtohen kërkesat per dizenjimin dhe përmbajtjen e etiketës.
- Ndryshojne klasat e etiketimit të energjisë. Klasat e energjisë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi A (A+, A++ dhe A+++)) nuk përputhen me produktet e tregut evropian të cilat janë në përputhje me rregulloren e re BE-së për etiketimin e energjisë përcakton një shkallë të re krahasuese për klasat e energjisë nga A (më efikase) në G (më pak efikase).
- Në ligjin e ri vendoset koncepti për përdorimin e etiketave të rishkallëzuara.
- Ndryshohet afati i ruajtjes së informacionit në lidhje me një model produkti të hedhur ne treg për një periudhë 15-vjeçare.
- Shtohen detyrimet e furnizuesi për informimin e klientit mbi përditësimin dhe për ndryshimet në parametra, duke përfshirë çdo ndryshim në klasën e etiketës.
- Furnizuesi nuk do të vendosë në treg produkte që janë projektuar në mënyrë të tillë që performanca e një modeli të ndryshohet automatikisht në kushtet e testimit
- Ligji aktual nuk parashikon programin vjetor të inspektimit për vitin pasardhës si dhe dërgimin e tij prane ministrisë përgjegjëse për energjinë për aprovim mbi pajtueshmërinë më këtë ligj.
- Parashikimi i fushatave informuese edukative dhe promovuese mbi etiketat e energjisë.
- Ligji aktual nuk parashikon procedurën për trajtimin e produkteve që paraqesin rrezik
- Ligji aktual nuk parashikon bashkëpunimin me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe Palët kontraktuese për ndryshimin e masave kombëtare për rastet specifike të kundërshtimeve. Kur Sekretariati konsideron se një masë kombëtare është në kundërshtim me ligjin e Komunitetit të Energjisë Sekretariati do të konsultohet pa vonesë me Palën Kontraktuese dhe furnizuesin ose, kur është e përshtatshme, tregtarin dhe do të vlerësojë masën kombëtare.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Inspektorati Shtetëror i Mbikqyrjes se Tregut do të jetë institucioni përgjegjës për zbatimin e opsionit të preferuar.

Gjithashtu, për zbatimin e opsionit të preferuar do të ngarkohen edhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe autoritetet doganore. Struktura përgjegjëse për mbikqyrjen e tregut është funksionale dhe operon në këto fusha që prej vitit 2012. Inspektorati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut është krijuar me VKM nr.36, datë 20.01.2016, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut”. ISHMT është një institucion në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i cili është përgjegjës për inspektimin në fushën e sigurisë së produkteve joushqimore për përdorim nga konsumatorët dhe sektorin e pronësisë intelektuale. Ndër të tjera Inspektorati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut është përgjegjës për inspektimin e zbatimit të legjislacionit parësor dhe dytësor në fushën e etiketimit të energjisë për produktet e lidhura me energjinë. Për inspektimin e produkteve me ndikim në energji është përgjegjës Sektori i Produkteve Elektrike.

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, do të zbatojë opsionin nëpërmjet kryerjes së kontrolleve me anë të:

- a. kontrollit të dokumentacionit; dhe
- b. kur është e përshtatshme, kontrolleve fizike e laboratorike në bazë të mostrave.

Gjithashtu, disa prej masave që do të ndërmerren ISHMT për zbatimin e opsionit do të jenë:

- a. Të urdhërojnë sjelljen e etiketave dhe skedave informative në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;
- b. Të kërkojnë nga furnizuesi dokumentacionin teknik, kur ka arsye të dyshojë për pasaktësi në informacionin e etiketave ose të skedave informative;
- c. Të marrë mostra dhe kryejë teste të konformitetit për saktësinë e informacionit në laboratorë të akredituar për këtë qëllim. Në rastet kur, në bazë të një raporti testimi, zbulohet se furnizuesi nuk ka dhënë informacionin e saktë ose ai është çorientues, të gjitha shpenzimet për kryerjen e raportit të testimit mbulohen nga furnizuesi, në të kundërt mbulohen nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut;
- d. Të urdhërojnë furnizuesin të marrë masa për të siguruar informacionin e saktë në etiketë ose skedën informative, brenda 30 ditëve pune, kur ka evidenca që produkti nuk është në përputhje me informacionin e dhënë;
- e. Të urdhërojnë tërheqjen nga tregu, ndalon shitjen ose lëvizjen e lirë të pajisjes, në rast se vazhdon shkelja referuar në shkronjën “ç” të këtij neni. Në raste të tilla, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut njofton ministrinë përgjegjëse për tregtinë/industrinë, së bashku me shpjegimet për këto masa;
- f. Të urdhërojnë, me shkrim, furnizuesin të ndalojë shkeljen, në rastet kur etiketa është bashkëngjitur në mënyrë të paligjshme;
- g. Të bashkëpunojë dhe asistojë në vlerësimin e shkeljeve të identifikuar nga autoriteti i doganave;
- h. Të vendosë masa administrative në përputhje me këtë ligj;
- i. Të sigurojë që prezantimi i të gjitha etiketave të reja dhe rishkallëzimi i etiketave të shoqërohet me fushata informuese edukative dhe promovuese mbi etiketat e energjisë. Nëse vlerësohet e përshtatshme ky proces realizohet në bashkëpunim me furnizuesit dhe tregtarët.

Të gjitha veprimtaritë e nevojshme për të garantuar zbatimin efektiv të opsionit të preferuar, do të përfshihen në programin vjetor të inspektimit për vitin pasardhës.

Autoritete doganore, nëse konstatojnë produkte që nuk janë në përputhje me dispozitat e ligjit, do të marrin masa për të njoftuar autoritetin përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut i cili mund të urdhërojë marrjen e masave për garantimin e sigurisë së përdoruesve fundor.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë do të jetë struktura përgjegjëse për trajtimin e ankesave. Në rastet kur ngrihen kundërshtime kundër një mase të marrë nga një Palë Kontraktuese, ose kur Sekretariati konsideron se një masë kombëtare është në kundërshtim me ligjin e Komunitetit të Energjisë, Sekretariati do të konsultohet pa vonesë me Palën Kontraktuese dhe furnizuesin ose, kur është e përshtatshme, tregtarin dhe do të vlerësojë masën kombëtare.

Mbi bazën e rezultateve të atij vlerësimi, Sekretariati do të vendosë nëse masa kombëtare është e justifikuar apo jo dhe mund të sugjerojë një masë alternative të përshtatshme.

Kur masat e ndërmarra nga Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut ose palë të tjera Kontraktuese nuk justifikohen nga Sekretariati i Komunitetit të energjisë, masat e ndërmarra do të tërhiqen menjëherë.

Supozimet për risqet që mund të pengojnë pritshmëritë:

1. Mosmiratimi në kohë i nismës, për arsye nga më të ndryshmet politike apo të tjera;
2. Vonesa në miratimin e akteve nënligjore të parashikuara nga ligji tej afateve ligjore apo edhe mosmiratimi i tyre;
3. Vonesa në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve njerezore të autoriteteve perkatëse të ngarkuara me zbatimin e ligjit;
4. Mungesa e interesit dhe financimit për prodhimin dhe përdorimin e Etiketimit të produkteve me ndikim në energji;
5. Masa të pajustificuara ligjrisht dhe arbitrare të ndërmarra nga Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut ose palë të tjera kontraktuese.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, (MIE) është institucioni kombëtar përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e politikave në fushën e efijencës së energjisë.

Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të MIE për zhvillimin e Industrisë dhe Energjisë është e përkushtuar ndaj zhvillimeve të efijencës së energjisë në vend dhe arritjen e objektivave kombëtar të përcaktuar për efijencën e energjisë dhe dekarbonizimin në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020-2030.

Kjo drejtori mbështetet nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Efijencës së Energjisë.

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut është përgjegjës për monitorimin e Etiketimit të produkteve me ndikim në energji dhe kryen vlerësimin e zbatimit të kësaj politike në praktikë. ISHMT përgatit programin vjetor të inspektimit dhe një kopje të rezultateve vjetore e dërgon pranë MIE mbi plotësimin e objektivave që parashikon duke raportuar me tej pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Programi vjetor i inspektimit, hartuar nga ISHMT, dorëzohet pranë MIE një herë në vit. Nëpërmjet monitorimit të këtij plani në mënyrë periodike, i cili do të evidentojë numrin e produkteve sipas klasave të energjisë të inspektuara në treg, do të llogaritet sasia e energjisë së reduktuar nga tregtimi i produkteve me klasë të lartë energjie.

Kriteret që do të shërbejnë për matjen e arritjes së objektivave janë:

- Reduktimi i konsumit të energjisë me 8.4%;
- Reduktimi i numrit të shkeljeve të konstatuara nga ISHMT;
- Reduktimi i numrit të masave administrative të vendosura nga autoritetet përgjegjëse;
- Numri i produkteve të tërhequra nga tregu.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

| | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | Viti 4 | Viti 5 | Viti 6 | Viti 7 | Viti 8 | Viti 9 | Viti 10 |
|---|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|---------|
| Faktori zbritës | | | | | | | | | | |
| Kosto për buxhetin – një herë | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Kosto për buxhetin – në vazhdim | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Kosto për biznesin – një herë | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Kosto për biznesin – në vazhdim | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Kosto për grupet e tjera – një herë | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Kosto për grupet e tjera – në vazhdim | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Kosto në total | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Përfitimi për buxhetin – në vazhdim | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Përfitimi për biznesin – një herë | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Përfitimi për biznesin – në vazhdim | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Përfitimi për grupet e tjera – njëherë | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Kosto për buxhetin – në vazhdim | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Përfitimi në total | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Vlera aktuale e kostos në total | - | | | | | | | | | |
| Vlera aktuale e përfitimit në total | - | | | | | | | | | |
| Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total | - | | | | | | | | | |

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

| Opsioni | Vlera aktuale në milionë lekë | | Vlera aktuale neto në milionë lekë |
|-----------|---|-----------|------------------------------------|
| | Kosto | Përfitimi | |
| Opsioni 1 | Pagat e punonjesve të MIE hartojnë politikat dhe pagat e punonjesve të ISHMT për inspektimin e produkteve me ndikim në energji. | | 3617028 |
| Opsioni 2 | Pagat e punonjesve të MIE hartojnë politikat dhe pagat e punonjesve të ISHMT për inspektimin e produkteve me ndikim në energji. | | 3617028 |